



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM



Raport Përfundimtarë i Mbikëqyrjes

Rezultatet e mbikëqyrjes, online, pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH)

Periudha e mbikëqyrjes: 01.01–31.12.2025

Teuta Kukaj:

Drejtor,

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Inspektorateve Qendrore

Drilona Baruti:

Përgjegjës sektori,

Spektori i Mbikëqyrjes për Inspektimet në Shëndetësi,

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Inspektorateve Qendrore

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Inspektorati i Përgjithshëm, në përputhje me ligjin nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, për periudhën 13 maj – dhjetor 2025, si dhe me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, për periudhën janar – 12 maj 2025, së bashku me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 11.06.2025 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm” dhe vendimin nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe administrimin e portalit unik ‘e-Inspektimi’”, ka ushtruar funksionin e mbikëqyrjes mbi veprimtarinë inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”, si dhe dokumentacionit fizik të administruar për vitin 2025.

ISHSH-ja, ushtron funksionet e saj në zbatim të VKM nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror shëndetësor”.

Në nivel qendror planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit; siguron unifikimin e praktikave të inspektimit, në shkallë vendi; bashkërendon veprimtarinë e laboratorëve dhe siguron kryerjen e analizave nga laboratorë të akredituar; informon publikun për veprimtarinë e inspektimit; jep mbështetje teknike dhe administrative për veprimtarinë e inspektimit; përgatit programin dhe raportin vjetor të inspektimit si dhe kryen drejtpërdrejt inspektime ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë.


Degët rajonale të ISHSH-së ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut përkatës dhe janë përgjegjëse për inspektimin.

ISHSH ka si qëllim kryesor garantimin dhe respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik, por edhe sigurimin e interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, për të ushtruar aktivitetin e tyre në zbatim të legjislacionit në fuqi që mbulohet nga ISHSH.

Për verifikimin e zbatimit të procedurave inspektuese, të ndjekura nga ISHSH, si strukturë përgjegjëse e specializuar për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, në fushën e shëndetit publik, Inspektorati i Përgjithshëm, mbikëqyri veprimtarinë inspektuese të realizuar online, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2025, me objekt: *mbikëqyrjen e respektimit të procedurave inspektuese lidhur me*

programimin, autorizimin, kryerjen e procedimit të inspektimit, si dhe ankimin e dënimit administrativ, në raport me ligjin e inspektimit dhe ligjet sektoriale.

ISHSH, gjatë vitit 2025, nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”, rezulton se janë realizuar 23696¹ inspektime, nga të cilat 19488 janë të programuara dhe 4208 jashtë programi (rreth 18%). Janë marrë 42² vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative gjobë, 501 vendime përfundimtare inspektimi me masa administrative paralajmërim, si dhe 24 Vendime të Ndërmjetme për Marrjen e Masës Urgjente.



Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese të realizuar online, u konstatua se:

Programi Vjetor i Inspektimit për vitin 2025, është hartuar në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe bazuar në prioritetet e përcaktuara për secilën fushë inspektimi. Ky program është sjellë për mendim këshillimor pranë Inspektoratit Qendror (të Përgjithshëm) me shkresë nr. 1454 prot., datë 14.10.2024, dhe është gjeneruar në portalin “e-Inspektimi”, pas dhënies së mendimit këshillimor nga Inspektoratit Qendror (i Përgjithshëm) dhe miratimit nga ministri linjës. Programi është sjellë brenda

¹ Inspektime të cilat janë me statusin “Mbyllur”.

² Në sistem rezultojnë 49 dënime administrative gjobë, por 7 dënime administrative janë marrë në inspektime të realizuara test dhe për të cilat do merren masat për bërjen e tyre inaktive (të mos shfaqen).

afatit ligjorë të përcaktuar në vkm nr. 696/16.08.2013³, ku përcaktohet se programi vjetor i inspektimit dërgohet për mendim këshillimor, brenda datës 15 tetor të vitit paraardhës.

Programet Mujore të Inspektimit, i janë përcjellë Inspektoratit të Përgjithshëm për mendim këshillimor, për periudhën janar - maj të vitit 2025, në formë elektronike dhe shkresore, përgjithësisht brenda afatit ligjorë, të parashikuara në kreun IV të VKM nr. 696/2013, brenda datës 15 të muajit paraardhës. Pas marrjes së mendimit këshillimor, janë gjeneruar në portalin “*e-Inspektimi*”.

Ndërsa për periudhën qershor – dhjetor 2025, në zbatim të pikës 6, të nenit 32, të ligjit nr. 99/2024, programet mujore të inspektimit janë dërguar për miratim pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, brenda afateve ligjore të përcaktuara, brenda datës 15 të muajit paraardhës.

Në disa raste, në autorizim përcaktohet se inspektimi realizohet **me njoftim paraprak**, por jo gjithmonë dokumentohet njoftimi i autorizimit në dosjet e krijuara në sistemin “*e-Inspektimi*”. Në inspektimet e realizuara nëpërmjet sistemit “*e-Inspektimi*”, autorizimi i njoftohet subjektit nëpërmjet sistemi “*e-Albania*”, ndërsa në inspektimet shkresore, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024, subjektit i njoftohet autorizimi, i cili e nënshkruan atë, por jo gjithmonë dokumentohet njoftimi.

Në rastet kur inspektimi realizohet **pa njoftim paraprak**, në shumë raste, në autorizim, nuk përcaktohet saktë arsyeja e mos njoftimit paraprak dhe vendimi i mosnjoftimit paraprak nuk motivohet, në kundërshtim me nenin 32, të ligjit nr. 10433/2011, për inspektimet e realizuara deri me 12 maj 2025 dhe nenin 40, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet e realizuara pas 12 maj 2025.

Procedura e inspektimit realizohet **me Autorizim**. Në disa raste autorizimi nuk plotësohet dhe mbahet plotësisht në përputhje me nenet 27, 28 dhe 29, të ligjit nr. 10433/2011, për inspektimet e realizuara deri me 12 maj 2025 dhe nenet 35, 36, 37, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet e realizuara pas 12 maj 2025. Në pak raste, procedura e inspektimit realizohet në subjekt jashtë afatit të përcaktuar në autorizim, për realizimin e procedurës së inspektimit në subjekt, në kundërshtim me nenin 29, të ligjit nr. 10433/2011 dhe nenin 37, të ligjit nr. 99/2024, duke e bërë që procedura e realizuar të mos prodhojë asnjë pasojë

³ Pika 1, kapitulli IV, vkm nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”.

juridike për subjektin e inspektimit. Në disa nga këto procedura inspektuese janë marrë edhe masa administrative.

ISHSH, realizon 17 % të inspektimeve **jashtë programi**. Në shumicën e rasteve inspektimi realizohet me kërkesë të subjektit për pajisjen me Akt-Miratimi Higjieno-Sanitar; me urdhër të kryeinspektorit rajonal, riinspektim (Inspektim për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve), me urdhër të kryeinspektorit shtetëror, për cenim të shëndetit publik...etj, por në dosjen elektronike shpesh nuk dokumentohet arsyeja e realizimit të kësaj procedure, me dokumentacion bashkëlidhur.

Gjithashtu, janë realizuar 2243 inspektime jashtë programi me arsyetimin “Inspektim i Programuar” pasi këto subjekte janë programuar për tu inspektuar por programet mujore nuk janë krijuar brenda afateve ligjore dhe programuar mujor është hedhur jashtë programi.

ISHSH, e realizon procedurën e inspektimit online, me dokumentacion të miratuar për realizimin e veprimtarisë së inspektimit dhe listë-verifikimi. Veprimtaria inspektuese për periudhën janar – maj 2025 është realizuar kryesisht nëpërmjet **tabletës dhe aplikacionit mobile** të sistemit “e-Inspektimi, në rreth 96 % të inspektimeve dhe 4 % është realizuar nëpërmjet web-it, ku numrin më të madh të inspektimeve nëpërmjet web-it i ka: Drejtoria Rajonale Fier 23 %, Drejtoritë Rajonale Gjirokastrë 26 %, Drejtoritë Rajonale Shkodër 10%, ndërsa drejtoritë e tjera rajonale i realizojnë në më pak se 5 %. Për periudhën qershor – dhjetor 2025, procedura e inspektimit është realizuar **në formë shkresore** dhe më pas është ngarkuar në modulën përkatës në sistemin “e-Inspektimi”.

Nga mbikëqyrja rezulton se, në shumë raste, **ka pasaktësi** në plotësimin e dokumentacionit të veprimtarisë inspektuese, ka mangësi në dokumentimin e dosjes së inspektimit, në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit për inspektimin dhe ligjit sektorial, si dhe dokumentacioni nuk plotësohet në mënyrë korrekte.

Në pak raste, kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit në procesverbal është mbajtur jashtë afatit të përcaktuar në autorizim për realizimin e procedurës së inspektimit në subjekt, në kundërshtim me nenin 29, të ligjit nr. 10433/2011 dhe nenin 37, të ligjit nr. 99/2024.

Në disa raste, dënimi administrative nuk është marrë në përputhje me ligjin, ka raste kur masa administrative nuk është marrë në përputhje me masën e parashikuar në ligjin sektorial. Para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024, është marrë dënimin administrativ kryesorë Paralajmërim⁴ për shkelje për të cilat ligji sektorial parashikon masa administrative gjoba.

ISHSH me anë të shkresës nr. 399/1 prot., datë 15.04.2026, protokolluar pranë Inspektoratit të Përgjithshëm me nr. 637/1 prot. datë 20.04.2026, ka dërguar observacionet për Raportin Paraprak të Mbikëqyrjes.

Nga ISHSH Korçë është sqaruar se çështjet e krijuara nr. ISHSH-KO-2025-000651 dhe ISHSH-KO-2025-000648, janë krijuar si çështje test, por në përmbajtje të dosjes nuk identifikohet në asnjë pikë të saj që kemi të bëjmë me një çështje test, vetëm nga emri subjektit. Observacionet janë marrë në konsideratë për këto çështje të cilat janë hequr nga raporti përfundimtar, në të gjithë përmbajtjen e tij. Observacionet e tjera kanë në përmbajtjen e tyre kryesisht argumentime dhe arsyetime, por nuk ka kundërshtime, me prova dhe fakte, për gjetjet e konstatuara.

Raporti në vijim, pasqyron në mënyrë më të detajuar të gjithë procesin inspektues, rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet për veprimtarinë e inspektimit të realizuar nga ISHSH, me qëllim verifikimin e zbatueshmërisë së legjislacionit në fuqi nga ana e subjekteve fizike dhe juridike, për inspektimin në shëndetin publik, në kompetencë të ISHSH-së.

⁴ Parashikohet në pikën 1, të nenit 48, të ligjit për inspektimin dhe duhet të merret vetëm kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ.

METODOLOGJIA E PUNËS

Mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese, për periudhën Janar-Dhjetor 2025, u zhvillua nëpërmjet sistemit online të inspektimit “*e-Inspektimi*”, si dhe dokumentacionit fizik të administruar pranë IP-së. Kjo mbikëqyrje u bazua në:

- ✓ Kontrollin e Programit Vjetor të Inspektimeve për vitin 2024;
- ✓ Kontrollin e Programeve Mujore të Inspektimeve;
- ✓ Përcaktimin e numrit vjetor të inspektimeve, brenda dhe jashtë programit;
- ✓ Kontrollin e dosjeve të inspektimit;
- ✓ Përcaktimin e numrit të masave administrative, gjobë.

Në modulën e çështjeve të inspektimit, për identifikimin e subjekteve të inspektuara jashtë programi gjatë 2025 është përdorur filtri “Hapur nga” 01.01.2025 “Hapur deri” 31.12.2025. Një inspektim është konsideruar si i realizuar nëse ka statusin “mbyllur”.

Ndërsa në modulën “raporte” janë përdorë raportet e ndryshme që mundëson portali unik i inspektimeve “*e-Inspektimi*”, për të identifikuar veprimtarinë inspektuese të realizuar nga ISHSH gjatë periudhës për të cilën po realizohet mbikëqyrja.

ANALIZA

Raporti paraprak është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit për inspektimin dhe kërkesave të ligjeve sektoriale, nëpërmjet një analize të detajuar të procedurës inspektuese dhe dokumentimit të veprimtarisë së inspektimit të ushtruar pranë subjekteve fizikë dhe juridikë, duke analizuar veprimtarinë inspektuese për fushën e inspektimit që mbulon ISHSH dhe duke pasqyruar problematikat e hasura.

Kjo analizë u krye nëpërmjet shqyrtimit të programit vjetor të inspektimit, programeve mujore, si dhe të dokumentacionit të gjendur në dosjen e inspektimit, nëpërmjet portalit “*e-Inspektimi*”.

Për të hartuar këtë raport paraprak u realizua mbikëqyrja e dosjeve të inspektimit të realizuar nga ISHSH në vitin 2024, duke u përzgjedhur në mënyrë rastësore e 50 % të dosjeve me masa administrative gjobe, 20 % e dosjeve me masa urgjente, si dhe rreth 50 dosje me masa administrative paralajmërim apo pa masa administrative.

BAZA LIGJORE

- ✓ Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë”,
- ✓ Ligji nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- ✓ Vkm nr. 330, datë 11.06.2025, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm”;
- ✓ Ligji nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive⁵”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 26/2017 “Për produktet kozmetike”;
- ✓ Ligji nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9928, datë 9.6.2008, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- ✓ Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- ✓ VKM Nr. 241, datë 27.3.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”;
- ✓ VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”;
- ✓ Urdhër 25, datë 10.08.2018, për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, i ndryshuar, i Inspektorit të Përgjithshëm, etj...

⁵ Ndryshuar me Akt Normativ nr. 2, datë 11.3.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive””.

MBIKËQYRJA ONLINE E DOKUMENTACIONIT PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË INSPEKTUESE

I. Programimi i inspektimeve

Në zbatim të nenit 7, të ligjit për inspektimin⁶, “një subjekt mund të inspektohet vetëm në zbatim të programit të inspektimit. Përfundimisht, një subjekt mund të inspektohet jashtë programit në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj” dhe në zbatim të pikës 1, të kreut IV, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013⁷, “Programet vjetore të inspektimit hartohen mbi bazë tematike dhe mbështetur në metodologjitë e vlerësimit të riskut e në detyrimin për inspektimin periodik, në rastet e parashikuara nga ligji i posaçëm dhe i dërgohen për mendim Inspektoratit Qendror brenda datës 15 tetor të vitit paraardhës. Gjithashtu në zbatim të pikës 2, të kapitullit IV, të vendimit nr. 696/2013, “Programet mujore të inspektimit të inspektorateve shtetërore hartohen mbi bazë subjektësh inspektimi dhe i dërgohen për mendim Inspektoratit Qendror brenda datës 15 të muajit paraardhës”.

Gjithashtu në zbatim të pikës 4, të nenit 30, nenit 32 dhe nenit 33 të ligjit nr. 99/2024, programi vjetor i inspektimit hartohet nga inspektoratet qendrore bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut, prioriteteve dhe politikave të ministrisë përgjegjëse. Inspektorati qendror ia dërgon për mendim këshillimor programin vjetor të inspektimit Inspektoratit të Përgjithshëm, brenda datës 15 tetor të vitit paraardhës dhe pas marrjes së mendimit nga inspektori i Përgjithshëm, ia dërgon për miratim ministrit përgjegjës.

Programi mujor i inspektimit për çdo inspektorat qendror, në zbatim të pikës 6, të nenit 32, të ligjit nr. 99/2024, hartohet nga inspektoratet përkatëse dhe i dërgohet për miratim Inspektoratit të Përgjithshëm.

ISHSH, ka **Program Vjetor Inspektimi për vitin 2025**, i cili është dërguar për mendim këshillimor pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, në përputhje me pikën 3, të nenit 24, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me anë të shkresës nr. 1454 prot., datë 14.10.2024, e administruar pranë Inspektoratit të Përgjithshëm me nr. 485 prot., datë 15.10.2024, brenda

⁶ Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011.

⁷ VKM nr. 696, datë 16.8.2013.

afateve ligjore të parashikuara në pikën 1, të kapitullit IV, të vkm 696/2013⁸.


Me shkresën nr. 485/1, datë 16.10.2024, Inspektorati i Përgjithshëm ka shprehur dakordësinë lidhur me këtë program, i cili pas miratimit nga ministri i linjës është gjeneruar edhe në sistemin e inspektimit “e-Inspektimi”.

ISHSH harton **Programe Mujore**, mbi bazë subjektsh inspektimi dhe i ka përcjellë ato pranë Inspektoratit të Përgjithshëm për mendim këshillimor, deri në muajin maj të vitit 2025, në zbatim të kërkesave ligjore të përcaktuara në kreun IV, të VKM nr. 696/2013. Ndërsa për periudhën qershor – dhjetor 2025, në zbatim të pikës 6, të nenit 32, të ligjit nr. 99/2024, programet mujore të inspektimit janë dërguar për miratim pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, të shoqëruara me listën e subjekteve që do t’i nënshtrohen inspektimit, kryesisht brenda datës 15 të muajit paraardhës, sipas parashikimeve ligjore.

II. Mbikëqyrja e dosjeve të inspektimit

Nga mbikëqyrja e realizuar online, nëpërmjet portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi”, rezulton se ISHSH, gjatë vitit 2025 ka realizuar 23696⁹ inspektime, nga të cilat 19488 janë të programuara dhe 4208 jashtë programi (rreth 18 %).

Inspektime 2025




■ Inspektime online nëpërmjet sistemit "e-Inspektimi" ■ Inspektime shkresore

⁸ Vendim nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi””.

⁹ Inspektime të cilat janë me statusin “Mbyllur”.

Nga të dhënat në sistemi e-Inspektimit rezulton se për periudhën janar – maj 2025 janë realizuar 10490 inspektime online nëpërmjet sistemit "e-Inspektimi" dhe për periudhën qershor – dhjetor 2025 janë realizuar 13206 inspektime shkresore.


Nga mbikëqyrja në sistem, për inspektimet e realizuara online nëpërmjet sistemit "e-Inspektimi" rezulton se janë celur në total 11478 inspektime nga të cilat 10490 janë në statusin “Mbyllur”, 987 “Anuluar” dhe 1 në “Progres”. Inspektimet e çelura për çdo drejtori rajonale po i pasqyrojmë në grafikun e mëposhtëm.



Procedura e inspektimit për periudhën janar – maj, 2025 është realizuar online, kryesisht nëpërmjet *tabletës dhe aplikacionit mobile* në rreth 96% të totalit të inspektimeve të realizuara, por ka një numër të konsiderueshëm inspektimesh, 421, të cilat janë realizuar nëpërmjet web-it.

Totali i inspektimeve nepermjet web-it dhe aplikacionit mbile


■ Web ■ Mobile



Drejtoritë rajonale që kanë numrin më të madh të inspektimeve nëpërmjet web-it janë: Drejtoria Rajonale Fier 23 %, Drejtoritë Rajonale Gjirokastrë 26 %, Drejtoritë Rajonale Shkodër 10%.

Inspektimet e realizuara online, nëpërmjet *tabletës dhe aplikacionit mobile*, sipas drejtorive rajonale paraqiten në grafikun e mëposhtëm:

INSPEKTIME NËPËRMJET APLIKACIONIT MOBILE



Vihet re se Drejtoria Përgjithshme (Qendrori), ISHSH Dibër, ISHSH Korçë, ISHSH Durrës, ISHSH Tiranë, ISHSH Vlorë dhe, i kanë realizuar inspektimet pothuajse në masën 100%, nëpërmjet tabletës dhe aplikacionit mobile.

Inspektimet në formë shkresor

Për shkak të mos përditësimit të sistemit elektronik “e-Inspektimi” me ndryshimet e fundit ligjore, Inspektorati i Përgjithshëm, me shkresën nr. 346 prot., datë 09.06.2025, ka kërkuar që procedurat inspektuese të kryhen fillimisht në formë shkresore me dokumentacion të printuar, për të mos ndërprerë veprimtarinë inspektuese.

Në këtë kuadër, ISHSH është udhëzuar që dokumentacioni i inspektimeve shkresore të ngarkohet më pas në sistemin “e-Inspektimi”, në modulën e çështjes, nënmodulën “Inspektim Shkresor”.

Nga procesi i mbikëqyrjes rezultojnë se janë realizuar **13206** inspektime në formë shkresore.


Ndërkohë, sipas Analizës Vjetore të ISHSH për vitin 2025, të vënë në dispozicion me shkresën nr. 247, datë 16.02.2026 dhe administruar pranë Inspektoratit të Përgjithshëm me nr. 313, datë 18.02.2026, nga ISHSH, rezultojnë se gjatë vitit 2025 janë realizuar në total 24049 inspektime.

Një përmbledhje e të dhënave të analizës së ISHSH po i paraqesim në tabelën e mëposhtme.

Qarku	Inspektime	Ri-inspektime	Monitorime	MA Gjobë	Vendime	Paralajmërimë
Berat	1036	2	43	0	1	36
Dibër	1110	0	496	0	0	2
Durrës	2449	31	626	7	10	210
Elbasan	1166	37	88	6	5	17
Fier	1809	9	0	1	0	232
Gjirokastrë	1106	1	55	0	0	414
Korçë	1534	7	59	4	0	12
Kukës	1280	9	2325	0	0	1
Lezhë	1223	96	0	0	0	69
Shkodër	1945	175	0	7	3	26
Tiranë	6128	57	0	26	3	58
Vlorë	3235	40	0	0	1	148
ISHSH qendror	28	0	0	0	0	0
Totali	24,049	464	3,692	51	23	1,225

Në këtë raport, Inspektorati i Përgjithshëm është mbështetur vetëm në të dhënat e gjeneruara nga sistemi “e-Inspektimi”. Mospërputhjet e të dhënave vinë edhe si rezultat i mënyrës së hedhjes së të dhënave në sistemin “e-Inspektimi”, në modulin e çështjes, nënmodulin “Inspektim Shkresor”.

Nga të dhënat e sistemit “e-Inspektimit”, për inspektimet shkresore rezulton se në total janë çelur 13762 çështje nga të cilat 13206 janë me statusin “Mbyllur”, 196 “Anulluar”, 255 “Hapur”, 103 në “Progres” dhe 2 në “Pritje”. Inspektimet shkresore të çelura për çdo drejtori rajonale po i pasqyrojmë në grafikun e mëposhtëm.




Gjatë vitit 2024, janë realizuar në total 4208 inspektime jashtë programi, të cilat kryesisht janë realizuar me kërkesë të subjektit për pajisjen me Akt-Miratimi Higjeno- Sanitar, rreth 34 %.

Rreth 54 % e inspektimeve jashtë programi janë inspektime për të cilat ka një program mujor të miratuar por për shkak të mos çeljes në kohë të programit mujor, në inspektimet shkresore, janë hedhur jashtë programi me arsye “Inspektim i Programuar”.

Rezulton se ka 2243 inspektime të cilat janë realizuar jashtë programi por të cilat janë të miratuara nga Inspektorati i Përgjithshëm, kjo sjell që numri real i inspektimeve jashtë programi të jetë vetëm 1905 inspektime, rreth 8 % e totalit të inspektimeve.

Inspektimet e realizuara gjatë vitit 2025 jashtë programi, sipas arsyes përkatëse po i paraqesim në formë grafike, në përqindje.

Inspektime jashtë programi sipas arsyes së inspektimit



ISHSH e realizon veprimtarinë inspektuese në **3 fusha inspektimi**:

1. Inspektime Sanitare,
2. Inspektime Shëndetësore,
3. Inspektime të tjera shëndetësore.

Gjithashtu ISHSH realizon edhe inspektime për plotësimin e standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe akreditimit të institucioneve shëndetësore ku rezultojnë se me kërkesë të subjektit janë bërë rreth 105 inspektime për Akreditim.

Inspektimet e realizuara për çdo fushë, paraqitet në grafikun e mëposhtëm.




Nga të dhënat e administruara në sistemin “e-Inspektimi” rezultojnë se gjatë vitit 2025, janë marrë masa përkatësisht:

1. 42 vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative gjobë¹⁰.
2. 501 vendime përfundimtare inspektimi me masë administrative paralajmërim.
3. 24 Vendime të Ndërmjetme për Marrjen e Masës Urgjente.


Më poshtë, pasqyrohen grafikisht dënimet administrative të marra gjatë vitit 2025.

¹⁰ Në sistem rezultojnë 49 dënime administrative gjobë, por 7 dënime administrative janë marrë në inspektime të realizuara test dhe për të cilat do merren masat për bërjen e tyre inaktive (të mos shfaqen).



Nga të dhënat e gjeneruara në sistem rezulton se pothuajse 71 % e dënimeve administrative gjobë janë marrë në inspektime jashtë programi dhe vetëm 29 % në inspektime të programuara.

Me poshtë pasqyrohen edhe në formë grafike dënimet administrative gjobë të marra, brenda dhe jashtë programi, për vitin 2025 nga ISHSH.



Ecuria e Masës Administrative

Për periudhën janar-maj 2025, në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 10433/2011, ankimi administrativ bëhej pranë trupës kolegjiale të ngrit pranë ISHSH, por nga të dhënat e administruara në modulën “Gjoba”, rezulton se nuk ka informacion nëse Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave ka shqyrtuar Vendime Përfundimtare Inspektimi.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024, i cili në nenin 55, parashikon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit ngrihet pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, rezulton se:

Pranë Inspektoratit të Përgjithshëm janë administruar 4 ankime administrative nga të cilat:

- 2 janë në proces;
- 2 janë shqyrtuar dhe komisioni ka vendosur shfuqizimin e tyre.

Nga shqyrtimi i dosjeve të inspektimit, të realizuara nga 12 drejtoritë rajonale dhe drejtoria qendrore, janë detajuar gjetjet e konstatuara sipas dokumentacionit të përdorur për realizimin e procedurës së inspektimit, si më poshtë:¹¹

❖ Autorizimi:

1. Në disa raste, kur inspektimi autorizohet jashtë programi, denoncim nga një i tretë, urdhër nga kryeinspektori rajonal/shtetëror, cenim për shëndetin publik, në dosje nuk dokumentohet me dokumentacion bashkëlidhur, arsyeja e realizimit të kësaj procedure, në kundërshtim me nenin 25 të ligjit nr. 10433/2011 dhe udhëzimit i IP nr. 25/2018 i ndryshua, dhe nenin 33, të ligjit nr. 99/2024. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000427; ISHSH-FR-2025-000161; ISHSH-SH-2025-000367.. etj.)
2. Në pak raste, inspektimi është autorizuar me 2 dhe jo me 3 inspektor, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 38, të ligjit nr. 99/2024, ku përcaktohet se inspektimi kryhet nga të paktën tre

¹¹ **Shembujt e cituar janë vetëm reference shembulli, të njëjtat shkelje janë konstatuar edhe në dosjet e tjera të mbikëqyrura.**

inspektorë, numri i anëtarëve të trupës inspektuese duhet të jetë numër tek. (P.sh.: ISHSH-KU-2025-000426; ISHSH-BR-2025-000292..etj.)

3. Në disa raste, inspektimi nuk motivohet dhe nuk përcaktohet baza ligjore e arsyes së mos kryerjes së njoftimit paraprak të autorizimit, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 10433/2011, për inspektimet deri ne 12 maj, dhe në kundërshtim me pikën 2, të nenit 40, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet pas 12 maj 2025. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000427; ISHSH-FR-2025-000161, ISHSH-DR-2025-000242-SHKRESORE; ISHSH-KU-2025-000426; ISHSH-SH-2025-000367; ISHSH-TR-2025-000580; ISHSH-TR-2025-000045; ISHSH-TR-2025-000585; ISHSH-EL-2025-000400-SHKRESORE; ISHSH-FR-2025-000148...etj.)
4. Ne autorizim nuk përcaktohet saktë:
 - a. Adresa e subjektit, rubrika “*Vendi/vendet ku do të kryhet inspektimi*”, në kundërshtim me germën f, të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 10433/2011 për inspektime deri me 12 maj dhe me germën g, të pikës 1, të nenit 36, të ligjit nr. 99/2024. (P.sh.: ISHSH-EL-2024-001415; ISHSH-TR-2025-000580¹²; ISHSH-BR-2024-001036¹³, ISHSH-BR-2025-000292; ISHSH-EL-2025-000400-SHKRESORE¹⁴...etj.)
 - b. Objekti i inspektimit, këtë rubrikë është përcaktuar arsyeja e inspektimit, në kundërshtim me germën b, të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 10433/2011, për inspektimet deri në datën 12 maj dhe me b, të pikës 1, të nenit 36, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet pas 12 maj 2025. (P.sh.: ISHSH-FR-2025-000161; ISHSH-TR-2025-000580; ISHSH-TR-2025-000045; ISHSH-EL-2025-000374; ISHSH-FR-2025-000148...etj.)

❖ Liste Verifikimi

¹² Në autorizim dhe procesverbal përcaktuar adresa ne qarkun Vlorë, ndërkohë që inspektimi realizohet nga qarku Tiranë.

¹³ Përcaktohet “në subjekt”.

¹⁴ Përcaktuar në vend.

1. Liste verifikimi nuk plotësohet në mënyrë korrekte nga trupa inspektuese në kundërshtim me pikën 3, të nenit 45, të ligjit nr. 10433/2011 për inspektimet deri në 12 maj dhe me pikën 6, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet pas 12 maj 2025:
 - a. nuk plotësohen në të gjitha rubrikat dhe nuk argumentohet arsyeja e mosplotësimit të tyre. (p.sh.: ISHSH-EL-2024-001485¹⁵; ISHSH-SH-2025-000367¹⁶; ISHSH-FR-2025-000148... etj.)
 - b. edhe pse nga trupa inspektuese konstaton shkelje e kërkesave ligjore në komente, përzgjidhet alternative “N/A” ose e lihet bosh (pa përcaktuar po, jo, N/A). (p.sh.: ISHSH-KU-2025-000426; ISHSH-BR-2024-001036...etj.)

❖ **Procesverbal inspektimi**

1. Në pikën 7 të procesverbalit, “*Shpjegimet apo kontestimet e subjektit*”, afati për paraqitjen e shpjegimeve apo kontestimeve, për faktet dhe rrethanat e konstatuara dhe të paraqitura në procesverbal, bëhet në kundërshtim me pikën 4, të nenit 45, të ligjit nr. 10433/2011, për inspektimet deri në 12 maj dhe me pikën 7, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024 për inspektimet pas 12 maj 2025.
 - a. nuk përcaktohet. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000427; ISHSH-EL-2024-001415; ISHSH-EL-2024-001485; ISHSH-FR-2025-000161; ISHSH-SH-2025-000367; ISHSH-TR-2024-005627; ISHSH-TR-2025-000580; ISHSH-TR-2025-000045; ISHSH-TR-2025-000585; ISHSH-BR-2024-001036; ISHSH-FR-2025-000148; ISHSH-KO-2024-001556; ISHSH-KO-2025-000370-SHKRESORE...etj.)
 - b. nuk përcaktohet brenda kërkesave ligjor. (p.sh.: ISHSH-DI-2025-000475-SHKRESORE¹⁷, ISHSH-SH-2025-000734¹⁸..etj.)
2. Nuk përcaktohet saktë baza ligjore e:

¹⁵ Listë verifikimi për produktet kozmetike.

¹⁶ Edhe pse inspektimi është realizuar me denoncim nga te tretet, objekti i inspektimit është inspektim sanitar dhe jo inspektim për pijet alkoolike, prandaj LV duhet te ishte plotësuar ne te gjitha rubrikat.

¹⁷ Përcaktuar 30 ditë por inspektimi është realizuar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024.

¹⁸ Lënë 12 dite, por inspektimi është realizuar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 99/2024

- a. gjetjes së konstatuar, në pikën 6 të procesverbalit, “Gjetjet e konstatuara”. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000427; ISHSH-BR-2025-000292; ISHSH-EL-2025-000374, ISHSH-SH-2025-000734..etj.)
 - b. kundërvajtjes administrative dhe/apo masa administrative, në rubrikën III të procesverbalit, “Kundërvajtjet Administrative”. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000427; ISHSH-DR-2025-000242-SHKRESORE; ISHSH-SH-2025-000367; ISHSH-BR-2024-001036; ISHSH-DI-2025-000475-SHKRESORE..etj.)
3. Në pak raste, ka mospërputhje midis të dhënave të përcaktuara në procesverbal me rezultatet e nxjerra nga sistemi për veprimtarinë inspektuese, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 45, të ligjit 10433, për inspektimet deri në 12 maj dhe me pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet pas 12 maj 2025:
- a. kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit në procesverbal, nuk përcaktohet saktë. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000242-SHKRESORE¹⁹; ISHSH-DR-2025-000244-SHKRESORE, ISHSH-DR-2025-000427²⁰, ISHSH-SH-2025-000734...etj.)
 - b. procesverbali është mbajtur jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në Autorizim, në kundërshtim edhe me nenin 29, të ligjit nr. 10433/2011 për inspektimet e realizuara deri ne 12 maj dhe nenit 37, i ligjit nr. 99/2024, për inspektimet pas 12 maj 2025. (P.sh.: ISHSH-TR-2024-005627; ISHSH-TR-2025-000045²¹....etj.)
 - c. nuk përputhet vendi i inspektimit i deklaruar në procesverbal me adresën e mbajtjes së procesverbalit. (p.sh.: ISHSH-EL-2024-001485²², ISHSH-TR-2025-000045²³, ISHSH-FR-2025-000148²⁴...etj.)
4. Në pak raste, në procesverbal nuk pasqyrohen te gjitha gjetjet e konstatuara në listë verifikimi. (p.sh.: ISHSH-EL-2025-000374²⁵; ISHSH-EL-2025-000400-SHKRESORE²⁶...etj.)

❖ Vendimi Përfundimtar i Inspektimit

¹⁹ Ora e fillimi dhe mbarimit.

²⁰ Ne procesverbal deklarohet se inspektim është realizuar nga ora 15:28 - 16:28, ndërkohë procesverbali është mbyllur në sistem në orën 15:05, para orarit të deklaruar për fillimin e veprimeve të inspektimit të deklaruar në procesverbal.

²¹ Autorizimi ka dale për një datë të mëparshme nga nxjerrja e tij.

²² Vendi i inspektimit deklaruar në Gramsh, inspektimi realizuar ne Elbasan.

²³ Inspektimi mbajtur në zyrë.

²⁴ Në procesverbal përcaktohet vendi i inspektimit Elbasan, inspektim realizuar ne Fier.

²⁵ Në LV konstatuar 4 shkelje.

²⁶ Nuk pasqyrohet shkelja e mospajisje me akt miratim.

1. VPI është marrë në shumë raste, aty për aty, në të njëjtën datë me mbajtjen e procesverbalit, pa i dhënë subjektit të drejtën për paraqitjen e shpjegimeve apo kundërshtimeve, për faktet, rrethanat dhe gjetjet e pasqyruara në procesverbal, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 45, të ligjit nr. 10433/2011, për inspektimet deri në 12 maj, dhe në kundërshtim me pikën 1, të nenit 43, dhe pikën 7, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet pas 12 maj 2025. Ligji sektorial nuk e parashikon që vendimi merret aty për aty. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000427; ISHSH-DR-2025-000242-SHKRESORE; ISHSH-DR-2025-000243-SHKRESORE; ISHSH-FR-2025-000161; ISHSH-TR-2025-000045; ISHSH-TR-2025-000585; ISHSH-BR-2024-001036; ISHSH-BR-2025-000292; ISHSH-DI-2025-000475-SHKRESORE; ISHSH-EL-2025-000374; ISHSH-EL-2025-000400-SHKRESORE; ISHSH-FR-2025-000148; ISHSH-KO-2024-001556; ISHSH-KO-2025-000370-SHKRESORE, ISHSH-SH-2025-000734....etj.)
2. Në disa raste nuk përcaktohet saktë baza ligjore, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 45, të ligjit 10433, për inspektimet deri në 12 maj dhe me pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet pas 12 maj 2025, e:
 - a. shkeljes së kërkesës ligjore të konstatuar. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000427; ISHSH-EL-2024-001485²⁷; ISHSH-BR-2025-000292; ISHSH-EL-2025-000374; ISHSH-GJ-2025-000108, ISHSH-SH-2025-000734..etj.)
 - b. kundërvajtjes administrative. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000427; ISHSH-DR-2025-000244-SHKRESORE; ISHSH-DR-2025-000243-SHKRESORE; ISHSH-KO-2025-000651; ISHSH-KU-2025-000426; ISHSH-BR-2024-00103; ISHSH-GJ-2025-000108...etj.)

²⁷ Citohet *nuk ka shkelje te kërkesave ligjore*, ndërkohe që është marre mase administrative.

3. Masa administrative nuk është marrë në përputhje me ligjin. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000242-SHKRESORE²⁸; ISHSH-DR-2025-000243-SHKRESORE²⁹; ISHSH-FR-2025-000148³⁰; ISHSH-GJ-2025-000108³¹...etj.)
4. Në disa raste, urdhërimi i subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, nuk shoqërohet me një afat të arsyeshëm dhe vendimi nuk përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 48, të ligjit nr. 10433/2011 për inspektimet deri në 12 maj, dhe pikës 5, të nenit 44, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet pas 12 maj 2025. (p.sh.: ISHSH-DR-2025-000244-SHKRESORE; ISHSH-EL-2024-001485; ISHSH-KU-2025-000426; ISHSH-SH-2025-000367; ISHSH-BR-2024-001036; ISHSH-BR-2025-000292; ISHSH-GJ-2025-000108...etj.)

❖ Dokumentacioni i shqyrtuar

1. Në disa raste, dosja e inspektimi nuk përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit. Dosja përmban ka dokumentacion e shqyrtuar, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 45 dhe urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 25/2018, i ndryshuar për inspektimet deri në 12 maj, si dhe pikën 6, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024, për inspektimet pas 12 maj 2025. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-000427; ISHSH-DR-2025-000242-SHKRESORE; ISHSH-SH-2025-000367, ISHSH-EL-2025-000400-SHKRESORE; ISHSH-GJ-2025-000108...etj.)

²⁸ Trupa inspektuese ka cituar pikën 1, të nenit 57, të ligjit nr. 99/2024, si bazë ligjore të kundërvajtjes administrative, në masën gjobë 50000 lekë, e cila parashikon “Moskorrigjimi i shkeljeve nga subjekti i inspektimit brenda afatit përbën kundërvajtje administrative sipas përcaktimit në pikën 3 të nenit 44, të këtij ligji dhe dënohet me gjobë në vlerën nga 30 000 lekë deri në 50 000 lekë... Por pika 3, e nenit 44, parashikon se “Paralajmërimi, si masë administrative kryesore, vendoset edhe për rastet kur për shkelje të lehta ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ. Në këtë rast, subjekti i inspektimit dënohet me “paralajmërim”. Për shkeljen e konstatuar nuk jemi në kushtet ku ligji specifik nuk parashikon masë administrative pasi për secilën shkelje neni 28, i ligjit nr. 26/2017, i ndryshuar, parashikon: germa c, moskryerja e detyrave të përcaktuara nga shpërndarësi, sipas përcaktimeve të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë dhe germa ç) mosnjoftimi, sipas përcaktimeve të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 1 000 000 (një milion) lekë gjobë.

²⁹ Masa administrative nuk është marrë në përputhje me ligjin. Trupa inspektuese nuk ka cituar bazën ligjore të kundërvajtjes administrative, por ka përcaktuar masën administrative gjobë 50000 lekë. Për shkeljen e konstatuar ligji specifik nuk parashikon masë administrative 50000 lekë, por për secilën shkelje neni 28, i ligjit nr. 26/2017, i ndryshuar, parashikon: germa c, moskryerja e detyrave të përcaktuara nga shpërndarësi, sipas përcaktimeve të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë dhe germa ç) mosnjoftimi, sipas përcaktimeve të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 1 000 000 (një milion) lekë gjobë.

³⁰ Masa jo në përputhje me ligjin në kohën e marrjes së tij. Marrë masë administrative paralajmërim për shkelje për te cilat ligji sektorial parashikon gjobe.

³¹ Marrë masë administrative paralajmërim për shkelje për te cilat ligji sektorial parashikon gjobe.

❖ Nënshkrimi i dokumentacionit të inspektimit

1. Në disa raste, dokumentacioni i inspektimit nuk nënshkruhet në të gjithë elementët e tij nga trupa inspektuese, emër, mbiemër, NUI, nënshkrim. (P.sh.: ISHSH-DR-2025-001024³², ISHSH-DR-2025-000242-SHKRESORE; ISHSH-DI-2025-000475-SHKRESORE³³; ISHSH-EL-2025-000400-SHKRESORE³⁴; ISHSH-KO-2025-000370-SHKRESORE³⁵...etj.)
2. Në pak raste, procesverbalit nuk është nënshkruar, mban shënimin "Refuzon firmën" apo është bosh, nuk dokumentohet njoftimi i procesverbalit. (P.sh.: ISHSH-KU-2025-000426...etj.)

❖ Realizimi i procedurës së inspektimit pranë dhe në prani të subjektit

1. Nuk përputhet vendi i inspektimit i deklaruar në procesverbal me adresën e mbajtjes së procesverbalit. (p.sh.: ISHSH-EL-2024-001485³⁶, ISHSH-TR-2025-000045³⁷, ISHSH-FR-2025-000148³⁸;

³² Procedura nuk është nënshkruar nga e gjithë trupa inspektuese.

³³ Në LV nuk përcaktohen emër mbiemër i trupës inspektuese, në VPI nuk është nënshkruar nga trupa inspektuese.

³⁴ Në PV nuk përcaktohet NUI inspektorëve.

³⁵ Në LV nuk përcaktohen emrat dhe NUI trupës inspektuese.

³⁶ Vendi i inspektimit deklaruar në Gramsh, inspektimi realizuar ne Elbasan.

³⁷ Inspektimi mbajtur në zyrë.

³⁸ Në procesverbal përcaktohet vendi i inspektimit Elbasan, inspektim realizuar ne Fier.

KONKLUZIONE

Përsa trajtuam më sipër konkludojmë se:

1. ISHSH ka zhvilluar veprimtarinë inspektuese në përputhje me legjislacionin për inspektimin, duke përdorur dokumentacion standard dhe sistemin elektronik të portalit unik “e-Inspektimi”. Inspektimet janë planifikuar përmes programit vjetor dhe programeve mujore të gjeneruara në sistem. Për periudhën janar–maj, inspektimet janë realizuar kryesisht në mënyrë elektronike, nëpërmjet aplikacionit mobile dhe, në disa raste, përmes platformës web. Ndërsa për periudhën maj – dhjetor 2025, inspektimet janë kryer fillimisht në formë shkresore dhe më pas janë regjistruar në sistemin “e-Inspektimi”.
2. Konstatohet se, në disa raste, autorizimi i inspektimeve jashtë programi (denoncime, urdhra apo raste flagrante) nuk është i dokumentuar me arsyetim dhe dokumentacion shoqërues, në kundërshtim me nenin 25 të ligjit nr. 10433/2011 dhe udhëzimit i IP nr. 25/2018, i ndryshua, dhe nenin 33, të ligjit nr. 99/2024.
3. Evidentohet se, në pak raste, autorizimi i inspektimit është kryer me 2 inspektorë dhe jo me numër tek prej të paktën 3 inspektorësh, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 38, të ligjit nr. 99/2024.
4. Evidentohet se, në disa raste, mungon motivimi dhe baza ligjore për moskryerjen e njoftimit paraprak të subjektit, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 10433/2011 dhe pikën 2, të nenit 40, të ligjit nr. 99/2024.
5. Konstatohet se, në disa raste, autorizimi nuk plotësohet saktë, konkretisht:
 - a. nuk përcaktohet saktë adresa e subjektit, në kundërshtim me germën f, pika 1, neni 28, ligji nr. 10433/2011 dhe germën g, pika 1, neni 36, ligji nr. 99/2024;
 - b. objekti i inspektimit nuk përcaktohet në përputhje me kërkesat ligjore, por zëvendësohet me arsyen e inspektimit, në kundërshtim me germën b, pika 1, neni 32, ligji nr. 10433/2011 dhe pika 1, neni 36, ligji nr. 99/2024.

6. Konstatohet se, në disa raste, lista e verifikimit nuk plotësohet në mënyrë të rregullt dhe të plotë, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 45, të ligjit nr. 10433/2011 dhe pikën 6, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024, konkretisht:
 - a. nuk plotësohen të gjitha rubrikat dhe nuk argumentohet mosplotësimi;
 - b. evidentohet mospërputhje ndërmjet konstatimit të shkeljeve dhe përzgjedhjes së alternativave (“N/A” ose bosh).
7. Evidentohet se, në disa raste, nuk përcaktohet ose nuk respektohet afati ligjor për paraqitjen e shpjegimeve apo kundërshtimeve nga subjekti, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 45, të ligjit nr. 10433/2011 dhe pikën 7, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024.
8. Konstatohet se, në disa raste, nuk përcaktohet saktë baza ligjore e gjetjeve të konstatuara dhe e kundërvajtjeve administrative/masave, në kundërshtim me kërkesat ligjore për argumentim dhe ligjshmëri të aktit administrativ.
9. Evidentohet se, në pak raste, ka mospërputhje midis të dhënave të procesverbalit dhe sistemit të inspektimit, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 45, të ligjit nr. 10433/2011 dhe pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024, konkretisht:
 - a. nuk pasqyrohet saktë kohëzgjatja e inspektimit;
 - b. procesverbali mbahet jashtë afatit të autorizuar, në kundërshtim edhe me nenin 29 të ligjit nr. 10433/2011 dhe nenin 37 të ligjit nr. 99/2024;
 - c. nuk përputhet vendi i inspektimit me adresën e deklaruar.
10. Konstatohet se, në pak raste, procesverbali nuk pasqyron të gjitha gjetjet e evidentuara në listën e verifikimit.
11. Evidentohet se, në shumë raste, vendimi përfundimtar merret në të njëjtën ditë me mbajtjen e procesverbalit, pa respektuar të drejtën e subjektit për paraqitjen e shpjegimeve apo kundërshtimeve, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 45, të ligjit nr. 10433/2011 dhe nenin 43, si dhe pikën 7, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024.
12. Konstatohet se, në disa raste, baza ligjore e shkeljeve të kërkesave ligjore dhe kundërvajtjeve administrative nuk përcaktohet saktë, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 45, të ligjit nr. 10433/2011 dhe pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024.

13. Evidentohet se, në disa raste, masa administrative nuk është marrë në përputhje me ligjin për inspektimin dhe legjislacionin sektorial.
14. Konstatohet se, në disa raste, vendimi nuk përmban afat të arsyeshëm për korrigjimin e shkeljeve dhe nuk shoqërohet me këshillim me shkrim për subjektin, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 48, të ligjit nr. 10433/2011 dhe pikën 5, të nenit 44, të ligjit nr. 99/2024.
15. Evidentohet se, në disa raste, dosja e inspektimit nuk përmban informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet inspektuese, gjetjet dhe vendimmarrjen procedurale, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 45, të ligjit nr. 10433/2011, urdhrin nr. 25/2018 të Inspektorit të Përgjithshëm (i ndryshuar), si dhe pikën 6, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024.

REKOMANDIME

Për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë inspektuese të ISHSH, rekomandojmë sa më poshtë vijon:

1. Të sigurohet dokumentimi i plotë i autorizimeve për inspektimet jashtë programi (denoncime, urdhra apo raste flagrante), duke përfshirë arsyetimin dhe dokumentacionin shoqërues, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 99/2024.
2. Të respektohet përbërja ligjore e grupit të inspektimit, duke garantuar që autorizimi të kryhet me numër tek prej të paktën 3 inspektorësh, në përputhje me pikën 1 të nenit 38 të ligjit nr. 99/2024.
3. Të argumentohet dhe dokumentohet në çdo rast moskryerja e njoftimit paraprak të subjektit, në përputhje me pikën 2, të nenit 40, të ligjit nr. 99/2024.
4. Të përmirësohet plotësimi i autorizimit të inspektimit, në përputhje me germën “g”, të pikës 1, të nenit 36, të ligjit nr. 99/2024, si dhe me pikën 1, të nenit 36, të ligjit nr. 99/2024, duke garantuar:
 - a. përcaktimin e saktë të adresës së subjektit;
 - b. përcaktimin e qartë të objektit të inspektimit në përputhje me kërkesat ligjore.
5. Të sigurohet plotësimi i rregullt dhe i plotë i listës së verifikimit, në përputhje me pikën 6, të nenit 42 të ligjit nr. 99/2024, duke:
 - a. plotësuar të gjitha rubrikat ose duke argumentuar mosplotësimin e tyre;
 - b. garantuar përputhshmëri ndërmjet konstatimeve dhe përzgjedhjes së alternativave.
6. Të përcaktohet dhe respektohet afati ligjor për paraqitjen e shpjegimeve apo kundërshtimeve nga subjekti, në përputhje me pikën 7, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024.
7. Të sigurohet përcaktimi i saktë dhe i plotë i bazës ligjore për gjetjet, shkeljet dhe masat administrative, në përputhje me kërkesat ligjore për argumentimin dhe ligjshmërinë e aktit administrativ, në përputhje me pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024.
8. Të garantohet përputhshmëria e të dhënave ndërmjet procesverbalit dhe sistemit “e-Inspektimi”, në përputhje me pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024, si dhe me nenin 37 të ligjit nr. 99/2024, duke siguruar:
 - a. pasqyrimin e saktë të kohëzgjatjes së inspektimit;
 - b. respektimin e afateve të autorizuara;

- c. përputhjen e vendit të inspektimit me adresën e deklaruar.
9. Të sigurohet që procesverbali të pasqyrojë në mënyrë të plotë të gjitha gjetjet e evidentuara në listën e verifikimit gjatë inspektimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024.
 10. Të respektohet e drejta e subjektit për paraqitjen e shpjegimeve apo kundërshtimeve, në përputhje me pikën 7, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024, duke shmangur marrjen e vendimeve përfundimtare në të njëjtën ditë me mbajtjen e procesverbalit.
 11. Të pasqyrohet e saktë baza ligjore për shkeljet e konstatuara dhe kundërvajtjet administrative, në përputhje me pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 99/2024.
 12. Të sigurohet që masat administrative të merren në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit për inspektimin dhe legjislacionin sektorial.
 13. Të garantohet që vendimi përfundimtar të përmbajë një afat të arsyeshëm për korrigjimin e shkeljeve dhe të shoqërohet me këshillim me shkrim për subjektin, në përputhje me pikën 4 të nenit 48 të ligjit nr. 10433/2011 dhe pikën 5 të nenit 44 të ligjit nr. 99/2024.
 14. Të përmirësohet administrimi i dosjes së inspektimit, duke siguruar që ajo të përmbajë informacion të plotë dhe të detajuar mbi veprimet inspektuese, gjetjet dhe vendimmarrjen procedurale, në përputhje me pikën 3 të nenit 45 të ligjit nr. 10433/2011, urdhrin nr. 25/2018 të Inspektorit të Përgjithshëm (i ndryshuar) dhe pikën 6 të nenit 42 të ligjit nr. 99/2024.

Nga mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese për vitin 2025, krahasuar me rekomandimet e lëna për mbikëqyrjen e realizuar për vitin 2024, rezulton sa më poshtë:

Nr. Rendor	Rekomandimi	Realizimi i rekomandimeve
1	Kur inspektimi autorizohet jashtë programi, në dosje, duhet të dokumentohet me dokumentacion bashkëlidhur, arsyeja e realizimit të kësaj procedure dhe në rastet kur inspektimi realizohet si rast flagrant, dosja e inspektimit duhet të përmban informacion për rrethanat e konstatimit të flagrancës, në përputhje me pikën 3, të nenit 45, të ligjit për inspektimin dhe urdhër nr. 25/2018.	<i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje por ka përmirësim.</i>
2	Kur inspektimi realizohet pa njoftim paraprak, arsyeja e mos njoftimit të autorizimit, në dokumentin autorizim, duhet të bëhet në përputhje me pikat 2 dhe 3, të nenit 32, të ligjit për inspektimin.	<i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje por ka përmirësim.</i>
3	Arsyeja e realizimit të inspektimit jashtë programi dhe procedura e inspektimit duhet të realizohet në zbatim të ligjit për inspektimi. Në çdo rast, në inspektime të programuara apo jashtë programi, procedura e inspektimit duhet të fillojë me gjenerimin paraprak të autorizimit, i cili i njoftohet subjektit para fillimit të veprimtarisë inspektuese, vetëm në rastet e parashikuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 27, të ligjit për inspektimin procedura mund të fillojë pa një autorizim të lëshuar paraprakisht.	<i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i>
4	Rubrika “objekti i inspektimit”, në autorizim, duhet të përcaktohet saktë dhe listë verifikimet duhet të çelen në sistem në përputhje me objekti i inspektimit, për inspektimin përkatës, në zbatim të germës b, të pikës 1, të nenit 28, të ligjit për inspektimin.	<i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje por ka përmirësim.</i>

5	<p>Shtyrja e autorizimit duhet të realizohet në përputhje me pikën 2 dhe 3, të nenit 29, të ligjit për inspektimin.</p> <p>Arsyeja e kërkesës për shtyrjes, duhet të jetë për shkak të kompleksitetit të veprimeve të inspektimit, kërkesa për shtyrje duhet bërë për një kohëzgjatje jo me të gjatë sesa autorizimi fillestar dhe para përfundimit të kohëzgjatjes së autorizimit fillestar. Vendimi për shtyrje autorizimi duhet të miratohet para përfundimit të kohëzgjatjes fillestare.</p> <p>Çdo veprim procedural i kryer jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizimin, nuk prodhon asnjë pasojë juridike për subjektin e inspektimit dhe ngarkon me përgjegjësi disiplinore inspektorin përkatës.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i></p>
6	<p>Në rastet kur autorizimi çelet pranë subjektit objekt inspektimi, duhet të dokumentohet prezenca.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i></p>
7	<p>Autorizimi duhet të lëshohet për një kohëzgjatje të mjaftueshme për realizimin e procedurës së inspektimit në mënyrë korrekte, në zbatim të ligjit. Në bazë të pikës 5, të nenit 29, inspektimi që zgjat më pak se katër orë llogaritet si inspektim gjysmëditor, ndërsa ai që zgjat më shumë se katër orë, llogaritet si inspektim 1-ditor.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i></p>
8	<p>Listë verifikimi duhet të plotësohet në të gjitha rubrikat me alternativat po/jo/nuk aplikohet (N/A), ndërsa komentet mund të jenë informacion shtesë për alternativën e përzgjedhur, shkeljet e konstatuara duhet të pasqyrohen në rubrikën përkatëse, në procesverbal. Listë verifikimi duhet të përshtatet me objektin e inspektimit apo aktivitetin e subjektit të inspektimit.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje por ka përmirësim.</i></p>
9	<p>Rubrikat e procesverbalit, duhet të plotësohen me korrektësi dhe në përputhje me dokumentacionin e miratuar, përkatësisht: rubrika "<i>Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit</i>", ku duhet të përputhet kohëzgjatja e inspektimit me orën e fillimit dhe mbarimit, rubrika "<i>Vendi/vendet ku do të kryhet inspektimi</i>" ku duhet të përcaktohet adresa e saktë, si dhe rubrika "<i>Njoftimi i procesverbalit të subjektit të inspektimit</i>".</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje.</i></p>
10	<p>Baza ligjore e shkeljes së kërkesës ligjore dhe e masës administrative, në procesverbal dhe vendim përfundimtarë të inspektimit, duhet të përcaktohet saktë, në zbatim të legjislationit në fuqi, pikës 3, të nenit 45, të ligjit për inspektimin dhe urdhrin nr. 25/2018.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje por ka përmirësim.</i></p>

11	<p>Procesverballi i inspektimit (dhe listë verifikimi si pjesë integrale e tij), duhet të nënshkruhet apo të dokumentohet njoftimi i tij në të gjitha rastet pasi në zbatim të pikës 1, të nenit 46, të ligjit për inspektimin, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektiv të inspektimit. Pas përmirësimeve dhe zhvillimeve të reja të realizuara në portalin unik të inspektimit “e-Inspektimi”, procesverballi (dhe dokumentacioni i inspektimit) i njoftohet subjektivit objekt inspektimi, në kohë reale, me gjenerimin e tij, nëpërmjet “e-Albania”.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i></p>
12	<p>Procedura e inspektimit duhet të mbahet brenda kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim. Në zbatim të pikës 4, të nenit 29, të ligjit për inspektimin, çdo veprim procedural i kryer jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim, nuk prodhon asnjë pasojë juridike për subjektivin e inspektimit dhe ngarkon me përgjegjësi disiplinore inspektorin përkatës.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i></p>
13	<p>Procedura e inspektimit duhet të mbahet pranë adresës së përcaktuar në autorizim dhe pranë e në prani të përfaqësuesit të subjektivit, në zbatim të pikës 2, të nenit 45, të ligjit për inspektimin.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i></p>
14	<p>Grupet inspektuese duhet të deklarojnë në procesverbal, kohëzgjatjen reale të realizimit të veprimtarisë inspektuese, pranë subjektivit objekt inspektimi, në rubrikën “Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit”, në zbatim të dokumentacionit të miratuar me urdhër nr. 25/2018 dhe pikës 3, të nenit 45, të ligjit për inspektimin.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje, por ka përmirësim.</i></p>
15	<p>Rubrika “Këshillime”, në procesverbal, duhet të plotësohet në mënyrë korrekte, duke lënë këshillime për përmirësimin e veprimtarisë së subjektivit apo realizimin e detyrave, në përputhje me nenin 40 dhe pikën 4, të nenit 48, të ligjit për inspektimin.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje, por ka përmirësim.</i></p>
16	<p>Gjetjet e konstatuar në procesverbal duhet të jenë të njëjta me gjetjet e konstatuar në listë verifikimi dhe të pasqyrohen me korrektësi në procesverbal, te rubrika “Gjetjet e konstatuara”, duke u përcaktuar çdo gjetje me vete, në zbatim të dokumentacionit të miratuar me urdhër nr. 25/2018.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i></p>

17	Vendim i Ndërmjetëm për Marrjen e Masës Urgjente, duhet të merret në përputhje me nenin 43, të ligjit për inspektimin dhe rubrika “Masa e marrë”, duhet të përshkruaj vetëm masën urgjente të marrë.	<i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i>
18	Shqyrtime për zgjidhjen e ankimit të veçantë, duhet të bëhet në përputhje me neni 44, të ligjit për inspektimin. Ankimi i subjektit dhe arsyetimi për marrjen e vendimit për zgjidhjen e ankimit të veçantë duhet të ngarkohen në sistem.	<i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i>
19	Vendimi Përfundimtarë i Inspektimit, kur parashikohet masë administrative, duhet të merret në respektim të pikës 4, të nenit 45, të ligjit për inspektimin, ku parashikohet se trupa inspektuese duhet të përcaktojë një afat për paraqitjen e shpjegimeve apo kontestimeve, nga subjekti objekt inspektimi, për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit.	<i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje.</i>
20	Detyrat duhet të lihen në përputhje me pikën 4, të nenit 48, të ligjit për inspektimin, me një afat kohor të përcaktuar për realizimin e tyre dhe në rubrikën përkatëse.	<i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje, por ka përmirësim.</i>
21	Dosja e inspektimit duhet të përmbajë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe duhet të shoqërohet me dokumentacion justifikues bashkëlidhur, në përputhje me pikën 3, të nenit 45, të ligjit për inspektimin dhe urdhër nr. 25/2018.	<i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje.</i>
22	Masa administrative duhet të merret në përputhje me parashikimin ligjor. ISHSH duhet të miratojë një metodologji për marrjen e masës administrative në mënyrë që, për dy subjekte të ndryshme, për të njëjtën shkelje, të mos merren masa administrative të ndryshme.	<i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje.</i>
23	Në vendim përfundimtarë të inspektimit duhet të plotësohet saktë data e njoftimit të procesverbalit, pasi në zbatim të pikës 1 të nenit 46, të ligjit për inspektimin, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit.	<i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i>

24	<p>Procedura inspektuese, e cila ka një vendim përfundimtarë inspektimi, nuk mund të anulohet nga kryeinspektori. Në zbatim të nenit 51, të ligjit për inspektimin dhe Kodin e Procedurave Administrative, vendimi përfundimtarë i inspektimit mund të jetë objekt ankimi, vetëm pranë organit kolegjal të krijuar pranë Inspektoratit Shtetëror.</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja nuk është konstatuar e njëjta shkelje.</i></p>
25	<p>Në zbatim të pikës 10, të Kreut XIII, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për Përcaktimin e Procedurave të Ushtrimit të Kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të Rregullave për Përmbajtjen dhe Administrimin e Portalit Unik “e-Inspektimi”, të pasqyrohet në sistem ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, papaguar/paguar, data e pagesës dhe kësti).</p>	<p><i>Nga mbikëqyrja është konstatuar e njëjta shkelje. Për periudhën janar-maj 2025 , ankimi i VPI nuk është bërë plotësisht në përputhje me nenin 51, të ligjit nr. 10433/2011 dhe akteve nënligjore. Me hyrje në fuqi të ligjit nr. 99/2024, ankimi bëhet pranë IP.</i></p>

Për Inspektoratin e Përgjithshëm:

Drilona Baruti